



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

Nga sesioni i dëgjimit të përgjithshëm publik me qytetarët e ndërtesës te rrethi në hyrje të Prishtinës, mbajtur më 23. 10. 2024.

Në sesion morën pjesë: Alban Zogaj nënkryetar i Komunës së Prishtinës, Osman Bllaca koordinator i dëgjimeve publike, Luljeta Selimi koordinatorë, Bekim Gashi zyrtar nga drejtoria e Shërbimeve Publike, Lulzim Fushtica drejtor i Drejtorisë për Siguri, Visar Geci arkitekt, Bashkim Sadiku zyrtar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Sesionin e dëgjimit publik e hapi dhe e kryesoi z. Osman Bllaca ku njëherit edhe ia dha fjalën nënkryetarit të Komunës së Prishtinës z. Alban Zogaj.

Nënkryetari Alban Zogaj: i përshëndeti të pranishmit duke i falënderuar përpjesë marrje masive në këtë dëgjim publik.

Si për fillim të pranishmit i informoi se si ekip e kemi kompanin implementuese e cila ka me implementuar projektin dhe zyrtarët e tyre si drejtorët përgjegjës, drejtorin e Shërbimeve Publike, arkitektin e kryeqytetit Visar Gecin dhe jemi të gjithë zyrtarët që mundemi me dhënë shpjegime për këtë projekt.

Ai në vazhdim dha sqarime të nevojshme lidhur me implementimin e projektit duke theksuar se i kemi dy qëllime, e para është aspekti estetikë i ndërtesës sepse ka qenë njëra prej ndërtesave që është dukë keq dhe është në hyrje të Prishtinës të kryeqytetit tonë dhe qëllimi tjetër më madhor është aspekti i energjisë eficiente, siç do ta shohim nga prezantimi që e bënë ekipi jonë, do ta shikoni se sa shumë keni me kursy energji me këtë izolim dhe trajtim që po i bëhet ndërtesës.

Nënkryetari theksoi se është ndarë një buxhet në shumë prej 500.000 mij euro për fazën e parë dhe do ta vazhdojmë projektin me faza të tjera në mënyrë që të përfundoj ndërtesa në tërësi. Fillimishtë do të fillojmë me pjesën e parë të ndërtesës që është pjesa ballore e ndërtesës e duke vazhduar tutje nga ana e postës.

Nga ana e nënkryetarit Alban Zogaj u dhanë sqarime të nevojshme tha se jemi të përkushtuar që përveç kësaj ndërtese me vazhdu tutje e dhe me fasadim të ndërtesave tjera. Sot për herë të parë do ta shihni edhe pamjen e ndërtesës se si do të duket, unë atë ditë ju kam njoftuar se do të ketë pamjen e soliterave të Ulpianës dhe sot keni me e pa për së afërmi.

Osman Bllaca: duke falënderuar nënkryetarin e Komunës së Prishtinës z. Alban Zogaj për sqarimet, fjalën ia dha projektuesit Admirim Koliqi.

Admirim Koliqi : dha sqarime lidhur me fazën e ndërtesës së Ulpianës, ku thotë se ne e kemi pas të arsyeshme këtë fazën e parë të kryhet kjo ndërtesa ballore komplet, shkurtimisht paraqiti çka ka qenë qëllimi i këtij investimi nga ana e Komunës dhe me e pa ju ma detaisht se si do të duket dhe çka do të arrijm mbas këtij projektit, të cilat faza duhet me i kalu që me arritë deri te kursimi i energjisë termike.

Projekti është fasadimi i ndërtesave të vjetëra, auditimi është bërë për ndërtesën Ulpiana në kuadër të projektit janë të dhëna infortmatat mbi ndërtesën në bazë të kushteve të jashtme dhe analizen që është bërë pjesa e mureve është kryesisht e pa izoluar disa e kanë izoluar me pjesë vetanake kurse disa të tjerë e kanë bërë ndrrimin e dritareve me fonde vetanake.

Ky objekt ka nevojë për rinovim dhe këtë renovim jemi tu e bërë në kuadër të këtij projektit. Qëllimi kryesisht është i identifikimit se ku ka nevojë ma shumë për me investu që me arritë një kursim të energjisë dhe me e pa se cili është aspekti i humbjes së energjisë. Do të bëhet edhe termoizolimi i kulmit si dhe me e bë ndrrimin e dymëve të hyrjes dhe dritareve të cilat do të zëvendësohen me dritaret e teknologjisë së fundit. Sipërfaqja e objektit është rreth 17,000 m²,ku 9,000 m² është sipërfaqe ngrohëse. Në 400 kW/m² konsumi specifikë që është shumë për atë objekt, d.m.th ka humbje të energjisë. Së bashku me arkitektin e qytetit Visar Gecin edhe me ekipin është bërë një projektë detaisht me material më të mira që janë në vend, izolimi më i miri që është që e ka një shkallë më të lartë të efijencës për me e bë një projektë më të mirë për ju. Izolimi i mureve ka me qenë me stiropoll 12 cm me një shkallë të lartë të efijencës që e kanë aspektin e energjisë termike, kurse pjesa e kulmit ka me qenë me një material që është i ri në tregë, e prezantoi materjalin që me e pa edhe fizikishtë, ky material është me dy shtresa të aluminit dhe një shtresë që është produktive dhe e zëvendëson njëzetshin leshin e gurit d.m.th një material i tillë me 1 cm është 13% më efikasë se njëzetëshi leshi i gurit dhe kulmi do të izolohet me këtë material kryesisht fasada do të jetë ngjyrë si e qumshtit por më mirë të themi si e pluhurit.

Visar Gashi: lidhur me projektin diskutoi edhe për ngjyrën e fasadës së ndërtesës e cila tha që ngjyra përshtatete dhe me ngjyrën e kulmit e cila është ngjyrë hiri dhe delë një kombinim shumë i mirë.

Admirim Koliqi: duke falënderuar Visarin për sqarimin profesional tha më shumë, mirë po me këtë aspekt është marrë arkitekti. Tregoi edhe cili ka me qenë modeli i gilinderave dhe terracen që ka me qenë në çdo pjesë të objektit që është në terracë.

Pjesa e llamarinës apo e kulmit të objektit me ngjyrë siç e potencoi arkitekti po ashtu edhe kulmi ka me qenë me atë ngjyrën si e tregoi më heret. Në tabelë tregoi si e ka paraqitë potencialin e kursimit të energjisë, dikund afër 38% ka kursim të energjisë vetëm në aspektin e izolimit sepse shumica e banorëve po ngroheshin me ngrohëse individuale ku produktin bazë e kishin energjin elektrike.

Te pjesa e rekomandimeve se çka kemi dashtë me arritë në këtë projektë ku këtu është reduktimi i CO₂, ku me këtë projektë kemi me ndiku edhe në aspektin e mjedisit ku kemi një kursim të CO₂ rreth 38% që ka me ndiku relativisht në mjedisë.

Osman Billaca: e falenderoi Admirimin, ai tha se e hapim debatin me temen e lartëcekur, ku disa banorë që ishin të pranishëm i shprehen mendimet e tyre rrethë kësaj çështje.

Naim Lahu : shtroi pyetje për nënkryetarin z. Alban Zogaj se a është paraparë në projekt edhe mbulimi i ballkonit në katin e fundit, sepse betoni duke rënë prej lagështisë dhe është i dëmtuar shumë, si dhe çka do të bëhet këto te golat anësore që janë dritaret kati i fundit, të dalura jashtë 1m, ato të gjitha janë të kalbura. A do të rinovohet edhe ajo pjesa e kulmit komplet, a po si do të vepron.

Mensur Krasniqi: shtroi çështjen e energjisë, kyçjes së termokosit si dhe problemit të parkingut, ku mendoj se kishte me qenë mirë me i dhënë pak hapësirë e me i diskutuar edhe problemet tjera që i kemi kërkuar në takimin e kaluar dhe me pasur qasje pak më shumë në të.

Ismet Murseli: shtroi pyetje a do të vazhdojë puna me këtë trend të punës, me nga 2- 3 punëtorë me punuar, a po do të merret parasysh pak ky intensitet i punës sepse kjo punë që është duke u bërë që 1 muaj, neve po na duket që është vetëm sa për sy e faqe, me nga 2-3 punëtorë nuk shkohet me punuar një shtëpi private e jo në një objekt me kaç metra katror.

Admirim Koliçi : sa i përket pyetjes së z. Naim Lahu, tha se ballkonet a do të kenë mbulojë, si dhe do të ketë rinovim të objektit.

Ndërsa sa i përket kërkesës së z. Ismet Murseli tha se trendi i punës, qëndron me vend. Ne jemi duke e bërë, vetëm sa kemi filluar me fazën e parë domethënë, pjesën e skeleve edhe shumë shpejt vijnë 4 ekupe, pasi që edhe ne kemi një afat kur kemi me përfunduar, domethënë shumë më shpejt se sa që e kemi menduar, nëse moti na premt.

Nënkryetari: duke iu drejtuar të pranishmëve tha se ajo çka ju intereson shumë është rinovimi i brendshëm i objektit, pra siç iu kam thënë edhe atë ditë në takim po e ripërsëris. Pasi ta krijoni këshillin e banorëve, duhet me e lidhë një kontratë me NPB-në, në mënyrë që NPB-ja me i kryer renovimet e brendshme të objektit edhe normalisht pastaj me hy edhe në kontratë pagese me ata, sepse ata përveç rinovimit e bëjnë edhe mirëmbajtjen e objektit, edhe për mirëmbajtje iu vendosin një faturë, e cila është faturë simbolike me iu thënë. Pastaj ju paguani në baza mujore për me mirëmbajt objektin edhe me pagu pjesën e rinovimit. Kjo mbetet në fazën tjetër. Fillimisht ne do ta përfundojm pjesën e fasadimit të jashtëm të objektit, pastaj hyjmë me punime brenda objektit. Ndërsa sa i përket kyçje në "Termokos" tha se unë e kam marrë përsipër me komunikuar me termokosin edhe me pa mundësin që ajo ndërtesë e cila është tepër afër termokosit me u kyç. Kurse për çështjen e parkingut tha se ajo pjesë është më e lehtë do e rregullojmë pa problem.

Hazir Klaiçi: shtroi shqetësimin se kanë problem me gastronomitë, problem me kanalizim, do të thotë ato yndyrat çka mblidhen gypin 160 e mbyllin, po duhet nonstop me i pastruar ato, e ata nuk përgjigjen për këtë punë. Unë kaç desha sepse tjerat pyetje i kanë bërë, është shumë me rëndësi kjo ku është pjesa më e shëmtuar përballë do të thotë rrugës kryesore janë këta oxhakë. Në atë pjesën që e ka gjelbëruar, që e ka bërë komuna, ato faktikisht janë taksat tona, ato i kanë shkatërruar duke i shkelur. Prandaj kjo ka të bëjë me inspektionin më tepër.

Nënkryetari: duke iu përgjigjur z. Klaiçi tha se pajtohemi, do ta përcjelli këtë porosi tek inspektioni. Krejt çka ne flasim sot këtu, ky është dëgjim publik i hapur dhe transparent, krejt shënohen edhe në procesverbalin e këtij dëgjimi publik, kështu që ne do ta përcjellim tek

inspekcioni. Sa i përket lokaleve poshtë aty, ne nuk jemi në gjendje sektorit privat edhe gastronomisë si me thënë me ia imponuar ku ata duhet me u vendosë. Ata e dinë më së miri ku duhet me u vendos, ku ka treg për ata. Aty ka disa lokale që janë të famshme, edhe ne e shohim problemin që e shkaktojnë aty, edhe me trafik duke u ndalë, sidomos aty te disa hamburgerë e dynera "Aba" janë të famshëm aty. Vijnë prej krejt qytetit me u ndalë te "Aba" me marrë hamburgerë. Kjo e ka edhe të mirën e vetë, se e keni Abën aty afër, por i ka edhe të këqijat e veta se shkakton tollovi. Këtë e dimë ne por e kemi të vështirë me ia imponuar sektorit privat ku duhet me u vendos. Kurse, sa i përket elementeve që janë të jashtë ligjshme, si për shembull qyngat, dalja e jashtë në pronë publike e të tjera. Ato ne me inspekcionin i dënojmë edhe i trajtojmë. Kështu që do të ia përcjellim këtë porosi inspekcionit. Faleminderit.

Enver Gashi: shtroi shqetësimin lidhur me qyngat që shkojnë lartë te hamburgerët, janë bërë sikur raketa me qenë, plus tymi i tyre domethënë që po na shkaktojnë të gjitha ia kanë shtuar një gjë shtesë, domethënë një minus. Kisha pasë dëshirë që ato me u marrë parasysht, me ia bë një zgjidhje. Në rregull nënkryetarë, ke të drejtë që thua nuk mundemi me ia imponuar se ku me shku ata, është e drejtë e tyre. Mirëpo, tjetra është që ato qynga që kanë dalë në atë formë ashtu, nuk ka asnjë ndërtesë, as në Prishtinë as në Prizren sa e kam parë dhe asnjë qytet tjetër nuk kam parë ashtu në atë stad ku kanë ardhë ato.

Visar Geci: duke u ndërlidhur në diskutim tha se këtë herë po dalë në anën e banorëve, jo në anën e komunës sepse po mendoj që ju keni shumë të drejtë. Bizneseve nuk mundemi me i tregu ku me hap, por me ia vendos kushtet po. Për shembull mos me përdor gaca, grill. Atë rregull ne mundemi me vendos, ne si komunë. Ajo automatikisht e ndalon edhe me pasë një biznes si e ka një qebaptore, ose mundem me i bë me rrymë. Kushti tjetër edhe me ventilim që mos me i ardhë era. Qfarë bëjnë banorët lartë, me i ardhë 24 orë era qebapa nuk kisha mundur as unë me jetu. Edhe era e teshave, se teshat duhet me i terë diku e kuptoj edhe atë gjë, edhe është e pa pranueshme. Unë mendoj njejtë sikur ju kjo ishte vetëm me iu përkrahë. Në asnjë vend në botë nuk lejohen me u bë bizneset të cilat krijojnë domethënë me gaca me plin ku ka banim.

Ai mestjerash tha se nuk e di a mundemi edhe ne me i sjellë këto rregullore për mos me i lejuar, se më me rëndësi e kemi numrin e banorëve se numrin e bizneseve që janë aty.

Arianit Zeqiri: tha se sa po e shoh unë, më shumë jeni fokusuar te pjesa e fasadimit ku mundet me ia dhënë një pamje më të mirë kryeqytetit. Mirëpo desha me ditë te këto banesat që janë gjysmë të izoluara si me thënë disa janë me pesë disa janë me dy, i kam parë banesat sepse vet jam inxhinier. Si veprohet në këto raste edhe te tarracat ku disa banesa ka që edhe i kanë mbyllë tarracat. E pamë që grilat kanë me u bë në krejt objektin njejtë. Por desha me ditë te këto banesat që janë gjysmë të izoluara edhe të këto banesat që i kanë mbyllë tarracat, si kanë me u vepru. Edhe faza e parë deri ku është më sakët, ose kur ka me u vazhduar me faza tjera. Nëse mundeni me e dhënë këtë përgjigje.

Admirim Koliçi: unë të tregova në fillim të prezantimit se ne e kemi bë një auditim të rëndësishëm të objektit edhe e kemi parë që disa prej banorëve e kanë bë edhe një izolim me fonde vetanake me tresh me pesë me dhjetësh e kam parë. Izolimi duhet me qenë i përgjithshëm me dymbëdhjetësh, pasi që standardi i izolimit është me dymbëdhjetësh, nëse e ka me tresh shtohet pjesa tjetër, ose

nëse e kemi mundësinë me ia heqë edhe treshin e me e bë krejt dymbëdhjetësh. Kështu që kryesisht çdo pjesë, ose hapësirë e jashtme, objekti ka me qenë me stiropor dymbëdhjetësh, hyrjet do të bëhen me dyer të reja si dhe ka me iu mundësuar që në hyrje të kenë qasje vetëm banorët e ndërtesës, si dhe pjesa e tarracave do të izolohet.

Viktorë Zeneli: banorë i objektit shtroi pyetje, e para ka të bëjë lidhur me dritaret në hapësirat e përbashkëta se a do të jetë pjesë e fazës së parë apo duhet pritur deri sa të bëhet fasadimi.

Ndërsa pyetja e dytë ka të bëjë me çështjen e liftave se ku duhet drejtuar për çështjen e liftave pasi që secila hyrje e ka vendin e dedikuar për lift.

Nënkryetari: duke iu përgjigjur z. Viktor Zeneli tha se do të vendosen dritaret në koridoret tek pjesa e shkallëve, ku ndoshta është mirë edhe me e pasqyruar me pamje se për cilën pjesë po flitet saktësisht.

Kryetari Përparim Rama : duke i përshëndetur dhe falënderuar qytetarët e pranishëm në sallë tha se me keqardhje ju them se nuk mund të qëndroj deri në fund të debatit për shkak të agjendës që kam mirëpo ju sugjeroj se nëse keni pyetje jam i gatshëm të ju përgjigjem.

Edhe njëherë ju kërkoi falje se nuk mund të jem prezent deri në fund pasi që tani kam takimin e radhës por vetëm nuk munda të mos vijë të ju përshëndes.

Qytetari: shtroi shqetësimin lidhur me çështjen e liftave ku thotë se a ka mundësi që institucioni i juaj përmes ndonjë donatori të zgjedh këtë problem.

Kryetari: duke iu përgjigjur zotëriut në fjalë tha se këtu e kemi drejtorin z. Bekim Brestovci nga drejtoria e Shërbimeve Publike, dhe e kemi bërë një datë bazë prej kërkesave për lifta në të gjithë Prishtinën si dhe jemi duke shikuar që në bazë të nevojave me ju dhënë prioritet.

Pra, tani na mbetet që drejtoria e Shërbimeve Publike të organizojë një komisionë që të vijë dhe të analizojnë secilën hyrje qysh kishim me zgjedh problemin e liftave.

Bekë Gashi: të pranishmit i informoi se drejtoria e Shërbimeve Publike ka ndarë një buxhet për rregullimin e ashensorëve, mirëpo nga ana e juaj nuk kemi marr asnjë kërkesë zyrtare të cilën ne

duhet ta shqyrtojmë ku juve ju mbetet të drejtoheni tek Drejtoria e Urbanizmit për tu paisur me leje dhe të na e sillni neve në drejtori qysh kishim me e dhënë pëlqimin që me filluar me e bërë Rregulloren e ashensorëve.

Njëherit falenderoj Kryetarin që edhe për vitin e ardhshëm ka ndarë një fond të mjaftueshëm për rregullimin e ashensorëve në Komunën e Prishtinës për banesa të cilat veq se kanë nevojë për me u paisë me ashensorë.

Qytetari : shtroi pyetje për kryetarin a kish pas mundësi me na njoftu se cilin hap duhet me marrë na për legalizim të këtij objekti ose ku mundemi me u drejtu pak më kjashtë.

Pasi që këto investime që po kërkojnë banorët liftin e të tjera ne jemi të gatshëm për me participu diçka çka të ketë mundësi sepse ne me participim tonë kemi bërë kanalizim atë që e kemi, po ashtu kemi bërë ujësjellsinë, po ashtu edhe rrymen këto gjera janë jo të duhura që i kemi, që i shfrytëzojm por neve duhet me na adresu se ku mundemi me u drejtu ose si shkojnë procedurat.

Kryetari : duke iu përgjigjur zotëriut në fjalë tha se unë kam qenë për vizitë aty edhe më herët, dhe jam takuar me qytetarët të cilët kanë të njëjtën breng, sepse e di mirë se si është çështja e kësaj ndërtesës e cila faktikisht ka qenë e atyre familjeve të cilat kanë qenë me nevojë dhe nuk kanë pasur mundësi të shkojnë diku tjetër dhe janë vendosur në ato banesa.

Për shkak se edhe atëherë dhe sa herë jam takuar ju kam sugjeruar me u bë bashkë kështu si jeni edhe me pas një reprezentues, një avokat i cili në bazë të ligjeve të Kosovës sot mundet me pa se çka mundet me bë për juve, do të thotë nëse ju jeni aty që 25 vite, ju gjithësesi i keni disa të drejta do të thotë i fitoni të drejtat. Mirëpo unë nuk jam profesionistë në aspektin ligjorë, mirëpo edhe çka e di është që zyra e avokaturës e cila mundet me ju riprezentu të gjithëve. Ndërsa mua më duhet me analizu qështjen në detaj me pa se cilat janë të drejtat e juaja për secilen prej familjeve që janë aty, se siç e dini ato ndërtesa nuk janë të Komunës së Prishtinës, janë të Ministrisë së Mbrojtjes apo kanë qenë të armatës do të thotë nuk është një qështje e drejtpërdrejt me Komunën e Prishtinës sepse ndoshta do të ishte pak më lehtë me qenë me Komunë të Prishtinës ne nuk jemi.

Ai mes tjerash tha se duhet të keni një jurist që ju udhëzon se cilët janë hapat e radhës sepse nuk mundet as Kryetari i komunës, as Ministri, as Kryeministri se çka me ju thënë, por juristat mund të thonë sepse e dinë ligjinë dhe bazohen në ligj.

Qytetari : shtroi shqetësimin lidhur me një bllok tek banesat e bardha, i cili e ka të njëjtin status me sa e dijm ne, ato janë shitë, kush i ka shitë ato dhe çfarë statusi tjetër kanë pas ato?

Kryetari: duke iu përgjigjur zotëriut në fjalë tha se gjatë periudhës kohore 20-30 vjeçare kanë ndodh, shumë gjëra të ndryshme, do legale do jo legale, domethënë ke probleme të ndryshme në pjesë të ndryshme të kryeqytetit, po mënyra më e mirë po e them me e zgjedh një problem është në mënyrë ligjore. E kush mundet me ndihmu në mënyrë ligjore më së miri është juristi që është i profesionalizuar pikërisht për proceset ligjore në bazë të ligjit të Kosovës.

Ferki Raqi: shtroi pyetje se si ka mundësi të izolohet me steripor 12-sh pjesa tjetër e ndërtesës e cila të themi ka një teprim të pllakës dhe është diku 20 cm.

Admirim Koliqi: duke iu përgjigjur zotëriut në fjalë tha se ajo pjesë është më tepër e pjesës së arkitekturës se si ka me qenë.

Ai mes tjerash tha se i gjithë objekti do të jetë i izoluar si dhe do të vendosen dritaret e madhësisë së njëjtë siç i ka hije një ndërtesë.

Qytetari: shtroi pyetje, kur ka me përfunduar hapësira?

Admirim Koliqi : tha hapësira në këtë llot do të përfundohet deri tek ajo pjesa ku e ka frizerin Mensuri, pastaj pjesa tjetër nuk varet prej neve është Nënkryetari që kisha pas dëshirë me jap një sqarim, faleminderit.

Bekë Gashi: duke iu drejtuar të pranishmëve tha se jemi duke e pritë me 1 nëntorë kur e kemi miratimin e buxhetit në momentin që miratohet buxheti na vazhdojmë edhe me tenderimin e fazës së dytë, deri sa të përfundojnë tenderimet e fazes së parë ne veç se startojmë me fazen e dytë, do të thotë se kemi buxhet të buxhetuar për vitin e ardhshëm dikun dy milionë euro, kështu që në vitin e ardhshëm përfundon komplet projekti edhe faza e dytë, faza e parë përfundimi duhet me qenë 180 ditë apo 120 ditë.

Bashkim: tha se nëse kemi kushte të volitshme të temperaturave atëherë faza e parë përfundon diku për 180 ditë maksimumi.

Nerimane Bajraktari: përshëndetje i nderuari nënkryetar, i nderuar staf. Unë jam profesoreshë jam Nerimane Bajraktari dhe jetoj në këtë bllokun ku jeni intenzivisht duke punuar, skelet, procedurat e steroporit, po e shohim të arsyshme edhe bashkëpunimin me ata punëtor aty ku po ka nevojë. Meqenëse 90% e dritareve vetëm se janë vendos me iniciativë të vetë banorëve për shkak të rrethanave që kemi jetuar që 25 vite, dhe thjeshtë kanë mbetur edhe 10 % të dritareve pa u ndërru. Meqenëse është koha e përshtatshme ende është ngrohtësia, dje bisedova me Ilirin për me ardhë me i marr masat e dritareve të cilat nuk janë ndërruar që 30 vite prej atij sistemi tjetër kështu që nuk po shohim në mënyrë që të koordinohen procedurat e punës ngjitja e dritarve pastaj steropori, fazada, jo me bë fasaden pastaj prapë me prish dhe me i vendos dritaret, dritaret e dhomave te terrasave dhe njëkohësisht në katin atje tek kulmi është një lloj i dritareve ngjyrë metalike, të themi ngjyrë e arit e mbyllurë edhe ato të vendosen të reja. Në anën tjetër meqenëse është nënkulm aty jashtzakonishtë ka rrjedhje të rrjedhëshme të ujit prej kulmit, prandaj ju kisha lutë që të merret iniciativa, pikë së pari kulmi të rregullohet që të mos përlyhen edhe ollukt edhe fasada.

Osman Bllaca: falemiderit profesoreshë, atëherë përgjigjen e jep Admirimi.

Admirim Koliqi: atëherë faleminderit profesoresh për pytjen, siç e tregova edhe më herët vetëm se ka filluar prodhimi i dritareve na i kemi bërë edhe auditimin të rëndësishëm në ato vende ku e kemi pasë mundësi edhe pikërishtë në atë vendin ku e potencove, kam qenë personalisht disa vende nuk ishin të banuara hiç, një person ma ka hapur deren dhe pashë që ishte mbushur me shpezë, me pëllumba ishte mbushur krejt edhe në ato vende ku nuk janë të banuara kanë me u vendosë dritare krejt të reja.

Nerimane Bajraktari: duke u ndërlidhur në diskutim tha se deshta me shtu edhe këtë se ata nuk kanë ardh me i marrë masa që dy ditë. Iliri diçka jam munduar me marrë në telefonë po ju thoni se

i ka marr masat ndoshta të dritareve të koridorit kurse dritaret e banimit, të dhomave dhe dyerve të terrasave nuk ka ardhë akoma.

Admirim Koliqi: faleminderit shumë edhe për këtë e kam një përgjigje dhe më vjenë keq personalisht Mensurin e kemi prezent këtu dhe kemi qenë jo vetëm njëherë por disa herë, e kemi pas të pa mundur me hy pamvarësisht që i kemi ndëgju që janë brenda nuk e di pse ekziston arsya pse mos me ta hap derën, Mensuri ka qenë prezent aty që nuk kena mundur të kemi qasje edhe u mundu në aspektin e vetë, por tani e tutje si banorë ju lutem po e dini që po përfundon kjo fazë ju lutem të dini se ne kemi me dalë prap me i bërë disa matje.

Osman Billaca: a ka persona prezent që dëshiron me marrë fjalën, atëhere që nuk ka një nënpyetje shumë të shkurtër sepse jemi drejt përfundimit të debatit.

Banori: z. Nënkyetar deshta për të bërë një mirënjohje për iniciativen e juaj, që sa kohë kemi jetuar e dini çfarë kushte kemi jetuar dhe jetojmë, kjo është iniciativë e qëlluar e ajo çka do të bëhet tash kur keni filluar çdo iniciativë që është në të mirën tonë, prandaj dhe ne jemi të gatshëm që diku bashkë të gjithë banorët diku me investu dhe participu në këtë iniciativë.

Osman Billaca: faleminderit.

Hajdar Bekteshi : tha se deshta për të bërë një pyetje arkitektit nëse e ka planin përpara që ka qenë i atij banimi aty mundet me i gjetë edhe oxhakat që vazhdojnë deri lartë të brendshëm edhe hyrjet, deshta me njoftu që në atë planë përpara nëse nuk e gjenë ne mundemi me ia gjetë.

Enver Gashi : shtroi pyetje për nënkryetarin lidhur me ushtruesin e detyrës z. Sokol Sadiku se a është nënadministrimin e tij parkingu "Autoprishtina".

Ai në vazhdim tha se ndihet i diskriminuar nga ana e tij për shkak të parkimit të veturës ku unë atë parking e shfrytëzoj që 20 vite, dhe tani jam detyruar të bëjë kontratë fiktive sepse sipas fjalëve të z. Sadiku mua nuk më takon që ta parkoj veturën aty edhe pse kam paguar 225 euro në vit për dy vetura kurse tani 480 euro në vit.

Nënkryetari : duke iu përgjigjur zotëriut në fjalë tha se na dërgoni një letër ankesë të strukturuar kështu siç po e shpjegoni situatën dhe mandej ne e shohim dhe e trajtojm.

Osman Bllaca : faleminderit shumë Enver, faleminderit nënkryetar për sqarimet.

Mensur: tha se vetëm deshta me ju falënderuar për angazhimin e juaj që e keni gjeture kohë me bashkëbisedu me neve, pra na duhet një përkrahje përmes inspektorave Komunal, siç e cekim Admirimi për hymje nëse veç vendoset ajo derë e hymjes ajo e ndreq atë vend por edhe kushtet e jetesës .

Naim Lahu: shtroi pyetje për nënkryetarin lidhur me statusin e këtyre banesave se këto banesa janë ndërtuar për refugjatë nga Koriacia apo Serbia siç është thënë më parë.

Ai në vazhdim tha se Kosovës raste ka pasur edhe në Vushtri dhe Pejë të viteve të 90-ta.

Ai në mes tjerash cekim edhe problemin e parkingut aty tek banesat përballë tek "Fellini" ku është me pagesë të gjithë ata çka nuk paguajnë vijnë në pjesën tonë, plus e kemi edhe një vullkanizer një zotëri shumë i madhë që i rregullon goma dikujt pa pare, p.sh vjen ndonjë inspektorë ai ka vendos edhe shirita të bardhë ka kufizu hyrjen, ka qenë edhe inspekcioni kemi lajmruar. Edhe Floriana para 7 apo 8 muaj, kanë ardhë dhe kanë thënë se nuk kanë çfarë të bëjnë, unë nuk e di që në pronë publike mundet me kufizu me vija të bardha diku 4 metra, kemi pas probleme të mëdha me të, ju kisha lutur që edhe këtë vullkanizer të pakten dyqani mundet me u leju, por vullkanizeri jo.

Arben Podrimqaku : duke u ndërlidhur në diskutim tha se edhe unë jam pjestar i asaj banese aty, dhe deshta me u ndërlidh me punën e statusit, do të thotë në vitin 2003 mua më ka paditë Oliver Ivanoviç, unë kam dosje të gjitha dokumentat që më ka paditë me marrë banesën për atë kohë ka qenë Habitati, do të thotë nuk ka gjetë asnjë bazë juridike që ka pas pjesë përshembull Oliveri ose ndokushë në ato banesa edhe ju është refuzu lënda sepse ata më kanë paditë për me u largu prej banesës por nuk kanë mundur sepse kanë gjetur fakte, ai ka parashtrur fakte kinse ka qenë e tij dhe ia ka dhënë vajzës e të tjera. Unë e kam dosjen që nuk kanë mundur me gjetë pronar që dikush e ka pasur atë vend.

Banor: shtroi çështjen e parkingut ku duke iu drejtuar nënkryetarit të komunës z. Zogaj se në qoftë se kishit mundur me ndikuar tek "Prishtina Parkingu" me ndikua që të na pranojnë si qytetar që kemi të drejtë mu parku në Zona 2, përshembull që është zona aty. Sepse edhe unë si të gjithë që e kanë këtë përvojë edhe unë kam përvoja kam shkuar, kam kërku, e kam pas para dy viteve të drejtën e kartës 1 vjeçare, ndërsa ai më thotë jo sepse ndërtesa e juaj është pa status sepse nuk ke të drejtën mu parku në lagje faktikisht po vijnë të gjithë të tjerët.

Nënkryetari: duke iu drejtuar zotëriut në fjalë tha se po ju premtojë që do të komunikojm me "Prishtina Parkingun" tek e fundit ne ia caktojm zonat "Prishtina Parkingut" përmesë drejtorisë së Shërbimeve Publike, ne e kemi një rregullore ku thuhet qartë DSHP-ja drejtoria jonë ia caktonë zonen "Prishtina Parkingut" edhe i thot merre këtë zonë në menaxhim, vendosi vijat, jepi lejet edhe le të paguajnë qytetarët ata që e kanë veturen e parë e kanë falas të dyten fillojnë me pagu dhe kështu i marrin lejet andaj është detyrë e jona me fillu me analizu këtë punë me komuniku me ta edhe me ju thënë vendoseni në sistem të parkimit edhe atë pjesë aty, atë përballë e ka Dardania dihet por duhet edhe ju me pas sepse nuk ka rëndësi kjo me statusin kjo është punë e menaxhimit të hapsirës publike jashtë ndërtesës, kështu që ne do e rregullojm po ju premtojë, atëherë faleminderit shumë ishte knaqësi me ju taku të gjithëve.

Osman Billaca: faleminderit shumë për pjesëmarrje, mirëupafshim në takime tjera.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Diskutim publik me qytetarët e ndërtesës te rrethi në hyrje të Prishtinës

23 tetor, 2024

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	JSMET	MURSELI			
2	Haxhi	KESTRA			
3	GURR	MURTI			
4	FERRI	RAFI			
5	Fehmi	Zegjiri			
6	ARENK	ČEKUJKI			
7	Roqja	CLAVRAN			
8	Muhamed	Hyshmani			
9	ARRAN	PODRIĆI & AKU			
10	ARRANOR	PODRIĆI & AKU			

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen! *

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	BEARD	MUSTAFA			
12	ZEQIR	MUSLI GASHI			
13	EKUER	GASHI			
14	Boleviu	Mungj			
15	SYLETHAN	GASHI			
16	Naimane Boruckaj				
17	ARXIVIT FAHRE	ZEJRI			
18	Attalho	GASHI			
19	Arban	Lekaj			
20	MIAN	LAVU			
21	GLAVIT	VEJKOCERI			
22	DENIS	HOTI			
23	ADHE	GASHI			
24	NAM	METOLLI			
25	Bejtani	Bejtani			
26	FELIJA FALCIS				
27	VIKTOR	ZENELE			
28	SEJDI	SEJDI			

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!
 Pjesëmarrësit janë të njohuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen!

29									
30		Ampon							
31									
32									
33									
34									
35									
36									
37									
38									
39									
40									
41									
42									
43									
44									
45									
46									

Ampon

Mazoku

Ampon

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!
 *Pjesëmarrësit janë të njoftuar se giatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen! *

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
47	Muhamet	Ngjani			
48	Ardi	Bea			
49	VELI S	SOPI			
50	NAZMI	MUSLICI			
51	ENVER	TËRRIKOLLI			
52	Donika Armeta	Almeti			
53	BARM Armeta	GRYBDECI			
54	Ademis	Shkani			
55	SAZA	KOXH			
56	Talant	Grashu			
57	ENVER	ZENEÇI			
58	Kenur	Krasniqi			
59	Hajr	Haxhinella			
60	Adrat	CASHI			
61	Shkani	Dogushka			
62	Donize	Krasniqi			
63	BUTHI	REXHEPI			
64	HAZDAR	DEKTESHI			

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!
 Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen!